



**Republika e Kosovës**

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-  
01.Nr. zyrtar/ 2019



**Komuna e Kaçanikut**

**Procesverbal**

**Takimi i III-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019**

**Më 19.06.2019**

Në takim prezantuan:

**Besim Ilazi**, Kryetarë i Komunës

**Zahir Doda**-Drejtor i DAK

**Halim Shehu**, Komandant i Policisë-Kaçanik

**Kjani Sallahu**, (mediet, OJQ-të, zejtarët, PAK-të)

**Fatmir Qaka**,EVSB

**Ramadush Osmani**-Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

**Menduh Rexha**-Bashkësia Islame

**Shemsedin Abazi**-(KLSP)

**Jashar Selimi**-Zyra për Barazi Gjinore

Monitorues ishin zyrtarë nga OSBE-

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut z.Besim Ilazi dhe propozoi këtë rendite:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut
- 3.Inicimi dhe përzgjedhja për realizim i një projekti të sigurisë
- 4.Rekomandimet për parandalimin e rreziqeve potenciale gjat sezonit verorë
- 5.Të ndryshme

### **1. Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar**

- Procesverbali u miratua nga të pranishmit

### **2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut**

**Komandanti i Policisë:**Gjendja e sigurisë në komunën e Kacanikut në periudhën në mes dy takime ka qenë e qetë dhe stabile.Gjat kësaj periudhe kemi pasur rezultate në zbulimin e disa rasteve ku vlenë të theksohet se në shkollën fillore „Idriz Seferi”-Bob ,ku është demoluar një klasë e kësaj shkolle me ç'rast kemi zbuluar akterët që kan shkkaktuar kët demolim dhe rastin e kemi proceduar në gjykatë . Gjithashtu është zbuluar edhe autori i dëmtimeve të drunjëve dekorativ për gjat Buevardit „Ismajl Raka”, ku edhe ky rast është proceduar në instancat e tjera .

Gjat kësaj periudhe ka ndodhur edhe një kanosje me armë zjarri para objektit të gjykatës me ç'rast personi që ka shkaktuar kët kanosje fillimisht është mbajtur në arrest 48 orë e më pas nga gjykata ka marrë dënimin prej 30 ditë arrest shtëpiak .

Kemi pasur raste të vjedhjeve edhe nëpër shtëpi private , jemi në hulumtimin e këtyre rasteve dhe kërkoj një bashkëpunim të përkushtuar ngase kjo dukuri më së shumti ka qenë prezente në punimet e autostradës , ndërsa tani që këto punime kan përfunduar kjo dukuri mundë të përhapet edhe nëpër pistë tjetra .

Lidhur me parkingjet ilegale ne kemi dhënë edhe xhoba por që kemi hasur në vështirsi në lidhje me pronësinë e trotuareve andaj kërkoj nga komuna që të na siguroj dokumentacione në lidhje me kët qështje .

Në të gjitha këto aktivitete që kemi pasur gjat kësaj periudhe padyshim se duhet falënderuar qytetarët dhe Komunën për bashkëpunim.

**Kryetari:** është për tu përvendetur puna e policisë në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike si dhe në zbulimin e rasteve kriminale që kanë ndodhur në kët periudhë kohore . Është detyrë e qdo njërit që të angazhohet në përballimin e qdo sfide që paraqitet . Për

muajin ramazan jemi munduar që të krijojmë hapsira publike për parkingje dhe do të mundohemi që edhe për sezonin e verës të bëjmë të njetën gjë .

**Shemsedin Abazi:**Më intereson të dijë se ku ka arritur policia në zbulimin e personave të cilët kanë demoluar objektin e fushës sportive në fshatin Stagovë .

**K.i Policisë:** sa i përket rastit të demolimit të objektit në fjalë ne kemi arritë të zbulojmë personat falë edhe bashkëpunimit që kemi pasur me qytetarë dhe kët rast e kemi procedurë në instancat gjyqësore .

**M.Rexha:** raste të vjedhjeve më herët kanë ndodhur në selinë e Bashkësisë Islame por që kohëve të fundit kjo dukuri është përsëritur prap , andaj kërkoj një angazhim edhe më të madh në zbulimin e rasteve ngase kjo dukuri ka marr një hov të madh .

**K.i Policisë:** më herët ne jemi marrë me këto raste të cilat janë në procedurë të hetuesisë ndërsa për rastet e mëvonshme ne nuk kemi pasur asnjë ankesë apo informatë që kjo dukuri është përsëritur në kët objekt .

**Kjani Sallahu:** Para disa ditëve në një shtëpi të fshatit Rekë ka ndodhur një vjedhje me ç'rastë janë marrë një sasi e konsiderueshme e mjeteve financiare dhe më intereson të dijë se a ka të bëjë ky rast me konfiskimin e një arme të një personi dhe me arrestimin e 16 personave në territorin e komunës tonë?

**K.i Policisë:** arrestimi 16 personave është bërë nga niveli qendrorë dhe nuk ka të bëjë me rastin në fjalë , ndërsa konfiskimi i një arme nga një person para gjykatës ndërlidhet me rastin . Personit iu ka konfiskuar arma , është mbajtur 48 orë në paraburgim dhe tanj 30 ditë është nën arrest shtëpiak .

**Kjani Sallahu:** Viteve të fundit gjatë festës së maturantëve është bërë e zakonshme vozitja e makinave nëpër rrugë të qytetit dhe gjithandje komunës nga maturantë, të cilët nuk posedojnë patent-shofer. Më intereson të dijë se a janë marrë masa ndonjëherë për ta ndërprerë këtë dukuri që tashmë duket se është bërë traditë.

**K.i Policisë:** rregullat në trafik vlejnë për të gjithë njësoj por që ne nuk kemi hasur ndonjëherë në raste të tillë .

**J. Selimi:** është një shqetësim i madh për banorët e e lagjës së Manëve në Kaçanik të Vjetër në lidhje me një rrugë ku vozitës të pandërgjegjshëm vozisin me një shpejtësi të madhe. Mendoj se në kët rrugë duhet të vendosen policët e shtrirë për të penguar kët dukuri . Alarmante është edhe prerja ilegale e pyjeve e poashtu edhe mungesa e hapsirave për parkingje .

**Kryetari:** këto shqetësime janë evidente por që do të mundohemi bashkërisht sado pak ti zbusim .

**K.Sallahu:** Punimet në autostradë janë në përfundim e sipër dhe se brengosës është fakti se gjatë këtyre punimeve janë shkatërruar shumë rrugë. Më intereson të dijë se cili është angazhimi Komunës që këto rrugë të kthehen në gjendjen e mëparshme .

**Kryetari:** kët shqetësim ne vazhdimit e kemi ngritur në nivelin qendrorë dhe besoj që kemi me pasur një përgjigje pozitive dhe këto rrugë do të bëhen funksionale .

### **3.Inicimi dhe përzgjedhja për realizim i një projekti të sigurisë**

**Kjani Sallahu:** në takimin e kaluar është diskutuar që simbolikisht të dilet në teren dhe të njihemi më për së afërm me gjendjen në teren , të njihemi me problemet që i preukupojnë qytetarët dhe të evidentojmë problemet që dojnë zgjidhje .Si për shembull një problematikë që shpeshë është përmendur në takimet tona ka qenë mungesa e laurës dhe e sigurisë te hekurudha sidomos për nxënësit e shkollës së Dushkajës. Ky ka mundur të jetë njëri nga lokacionet të cilin do të duhej ta vizitonim dhe ta shohim nga afër.

**R. Osmani:** si nevojë e qytetarëve mundë të mirret edhe asfaltimi i rrugëve të qytetit të cilat janë të dëmtuara në masë të madhe . Gjithashtu sistemi i sinjalistikës është një nevojë e kahmotëshme e që duhet të punohet në kët drejtim që ky sistem të funksionoj . Ka probleme të llojlojshme që i preukupojnë qytetarin por që me kohë do të mundohemi ti zgjidhim këto probleme .

### **4.Rekomandimet për parandalimin e rreziqeve potenciale gjatë sezonit verorëi**

-Rreth kësaj pike fjalën mori **Ramadush Osmani** -Drejtor i Shërbimeve Publike dhe emergjencë , i cili tregoi për të gjitha masat që janë ndërmarrë nga Komuna për të evituar çdo rast që cënon sigurinë qytetare . Ai tha se kan përpiluar planin emergjent për reagim . Me kohë kemi njoftuar qytetarët për kujdesë gjatë kohës së korrje -shirjeve , do të bëjmë inspektime nëpër pishina , kemi shpërndarë njoftime për pasojat e keqpërdorimit të ujit të pijshëm , do të shikohet gjendja e përroskave dhe shumë veprime tjera që parandalojnë situata emergjente .

Në fund të takimit u nxjerrën edhe rekomandimet të cilat ishin:


- 1.Të mirren masa paraprake për sezonin e verës(prandalimin e zjarreve , ndotja akustike , parkingjet ilegale , ndotja e ambientit , prerja ilegale e pyjeve etj) .
- 2.Të bëhet meremetimi i rrugëve të dëmtuara
- 3.Përkushtim edhe më i madh në zbulimin e rasteve të vjedhjeve

**Kaçanik 19.06.2019**

Kryesuesi:

Kryetari i Komunës

**z.Besim Ilazi**



Procesmbajtës:

**Fatmir Qaka**